



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Posta Kosova D.Ö.

Nr./No./Br. 01-893/2026
Data/Date/Datum 13-05-2026
PRISHTINE-PRISTINA-PRISTINA

Në bazë të Nenit 8 të Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212), dhe Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së punës nr 01-3060/24, datë 31.12.2024 dhe Vendimin e Bordit të Drejtorëve me numër 01-861/26 datë 07.05.2026 PK Sh.A. me datën 13.05.2026 shpall:

KONKURS PUBLIK PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës:

1. Postier/e, (grada 3) 9 Ekzekutes

Nr. Referencës: 05/26

Përshkrimi: PK Sh.A., është duke bërë përpjekje për të zhvilluar biznesin sipas përvojave më moderne të shërbimeve postare dhe komerciale, për t'i arritur standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve postare dhe komerciale. Në këtë aspekt, PK Sh.A., ofron mundësi të barabartë punësimi të profesionistëve që synojnë të jenë pjesë e zhvillimit të biznesit dhe kompetencave të Ndërmarrjes në përputhje me metodat dhe praktikat moderne.

Kohëzgjatja e kontratës: Konform nenit 21 pika.9 nenin 23 dhe 24 të Rregullores për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës për Punonjësit e Postës së Kosovës Nr. 01-3060/24 datë 31.12.2024, kontrata e punës është për kohë të pacaktuar, në të cilën periudhë përfshihet edhe periudha provuese 6 muaj.

Pozita e punës: Postier - Regjioni i Prishtinës

Vendi i punës: (Prishtinë-2 ekzekutues)(Hajvali - 1 ekzekutues)

(F.Kosovë - 2 ekzekutues)(Lipjan - 1 ekzekutues)

Pozita e punës: Postier - Regjioni i Prizrenit

Vendi i punës: (Suharekë -1 ekzekutues)

Pozita e punës: Postier - Regjioni i Gjilanit

Vendi i punës: (Viti -1 ekzekutues) (Pozhoran – 1 ekzekutues)

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Pranon dhe shpërndan letër-dërgesat, kolipostat, apo produktet tjera që ofron PK Sh.A., të ndara/ngarkuara nga kartuesi/ja; Është përgjegjës/e për pranimin, dorëzimin e letër-dërgesave, kolipostave në rajonin përkatës; Bën shitjen e produkteve sipas shërbimeve që ofrohen nga PK Sh.A. dhe është përgjegjës/e për arritjen e targeteve të caktuara nga qendra për shitjen e produkteve; Mban përgjegjësi për produktet e pranuar për shitje, tel. USSD, evidencë, klasifikim dhe ruajtje të dokumentacionit manipulativ në baza ditore, dekadore dhe mujore; Zbaton ndryshimet e paraqitura në lidhje me shpërndarjen dhe dorëzimin; Është përgjegjës/e për mirësjellje, zbatimin e Kodit të Mirësjelljes dhe Kodit mbi Trajtimin e Dërgesave Postare; Kryen edhe punë tjera të nevojshme të parashtruara nga Kontrollori i Shpërndarjes/Kartuesi apo Përgjegjësi i Zyrës Postare; Për punën e vet i përgjigjet Kontrollorit të Shpërndarjes/Përgjegjësit të Zyrës Postare.

Kualifikimi dhe përvoja e nevojshme:

- Punonjësi/punonjësja, për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të Postierit/es duhet të ketë

kualifikim të mesëm shkollor, preferohet në drejtimin e shërbimit postar.

- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Të jetë shtetas i Kosovës.

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati, duhet t'i dorëzoj këto dokumente:

- 1 Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e PK-së <https://postakosoves.com/publikime/mundesipunesimi/>);
2. Diploma mbi shkollimin, (diploma e fituar jashtë Republikës Kosovës duhet të jetë e nostrifikuar sipas Ligjit);
3. CV-ja
4. Kopja e letërnjoftimit apo pasaportës valide;
5. Dëshmi nga Gjykata kompetente që ndaj kandidatit në fjalë nuk është duke u zhvilluar procedurë penale, jo më të vjetër se 6 muaj.

Mënyra e Aplikimi: Aplikacionet mund të merren online www.postakosoves.com dhe së bashku me dëshmitë përkatëse të dërgohen nëpërmjet postës në adresën: Arkiva e PK Sh.A., Ndërtesa Kryesore e PK-së, Rr. "28 Nëntori" nr. 4, 10000 - Prishtinë, deri në afatin e paraparë për aplikim me shenjën "PËR KONKURS", duke e cekur titullin e vendit të punës dhe Regjionin për të cilin aplikoni.

Aplikacioni dhe të gjitha dëshmitë bashkëngjiten të fotokopjuara, sepse të njëjtat nuk iu kthehen aplikantëve.

Aplikacionet e pakompletuara plotësisht nuk do të merren parasysh.

Aplikacionet të cilat dorëzohen pas afatit nuk do shqyrtohen.

Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Vërejtje: Dokumentacioni i dërguar për këtë konkurs duhet të jetë kopje (përveç certifikatës nën hetime të lëshuar nga Gjykata që me rastin e intervistës duhet të sjellët origjinal)sepse të njëjta nuk i kthehen kandidatëve.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

Konkursi është i hapur nga data 13.05.2026 dhe përfundon më datë 25.05.2026 ora 24:00

Kandidatët që i plotësojnë kushtet fillimisht do t'i nënshtrohen testit me shkrim dhe vetëm ata kandidatë, të cilët do të kalojnë testin, do të hyjnë në rrethin e ngushtë dhe do t'i nënshtrohen intervistës.

Nora Rraci

Kryeshef Ekzekutiv - Posta e Kosovës Sh.A.

